



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

TË DREJTA STUDIMI UNIVERSITARE DHE

PASUNIVERSITARE NË POLONI, VITI AKADEMIK 2017-2018

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit dhe shkencës me Poloninë, Ministria e Shkencës dhe Arsimit të Lartë të Republikës së Polonisë ofron të drejta studimi universitare dhe pasuniversitare për kandidatët shqiptarë, të cilët dëshirojnë të studiojnë në universitetet publike të Polonisë për vitin akademik 2017-2018.

Kandidatët të interesuar për këto të drejta studimi duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Integritimit dhe Projekteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dokumentet e mëposhtme:

Për studime universitare:

1. Kërkesën për studime, duke specifikuar degën në të cilën kandidati dëshiron të studiojë. Kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. Formularin e plotësuar në gjuhën polake me një fotografi me ngjyra;
3. Diplomën e Maturës Shtetërore / ose vërtetimin e notave për tri vitet e shkollës së mesme. Ky dokument duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria ose Zyra Arsimore e rrethit përkatës, si dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
4. Dokumentin zyrtar të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për pranimet në programet e studimit të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë;
5. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
6. Fotokopjen e faqes së të dhënave të pasaportës;
7. Dëshminë e penalitetit;
8. 4 fotografi dokumenti.

Për studime pasuniversitare:

1. Kërkesën për studime pasuniversitare, duke specifikuar degën në të cilën kandidati dëshiron të studiojë. Kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. Formularin e plotësuar në gjuhën polake me një fotografi me ngjyra;
3. Fotokopjen e noterizuar të diplomës së shkollës së lartë dhe listën e notave;
4. CV;
5. Dy letra rekomandimi;
6. Programin e studimit;
7. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
8. Fotokopjen e faqes së të dhënave të pasaportës;
9. Dëshminë e penalitetit;
10. 4 fotografi dokumenti.

Dokumentet e mësipërme duhet të përkthehen në gjuhën polake. Kandidatët për studime universitare/pasuniversitare në Poloni duhet t'i nënshtrohen vitit përgatitor të gjuhës polake, i cili fillon në 1 tetor të vitit 2017.

Shpenzimet e udhëtimit për në Poloni, si dhe shpenzimet e ushqimit dhe të akomodimit, të cilat shkojnë afërsisht 350 € në muaj, duhet të mbulohen nga vetë aplikantët. Pala polake merr përsipër tarifën e shkollimit dhe mundësinë për akomodimin dhe ushqimin me pagesë në konviktet dhe mensat e studentëve.

Për një informacion më të detajuar lidhur me kushtet e aplikimit, referojuni faqes së internetit të Zyrës së Njohjes së Arsimit dhe Shkëmbimeve Ndërkombëtare:

<http://buwilm.edu.pl/kwestionariusz-kandydata-na-ksztalcenie-wpolsce-pl-en/>

Afati i fundit për pranimin e dokumenteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit është data **04 gusht 2017.**

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE